



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.6/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Shukri Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen juridike të paditësit P. Gj. nga Komuna e ..., rr. ..., Lagja ... , kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Dardani p.n Prishtinë, i përfaqësuar nga L. S., për dëmshpërblimin e diferencës në pagë, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, CA.nr.178/2017, të datës 15.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë CA.nr.178/2017, të datës 15.01.2019.

A r s y e t i m i

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin CA.nr.178/2017, të datës 15.01.2019, ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1388/2013 i datës 20.10.2016, në pikën I dhe II, të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si i kundërligjshëm aktvendimi i të paditurës Telekomunikacioni i Kosovës nr. 01-1040-6/2012, i datës 07.03.2012. Në pikën III, të dispozitivit, është detyruar e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Dardania p.n. Prishtinë, që paditësit ti kompensoj

ndryshimin e pagës në mes të gradës 6 dhe 7 për periudhën 01.02.2012, e deri me 30.06.2016, në shumë neto prej 4,634.15 Euro, diferencën e kontributit pensional në fondin e trustit pensional në emër të punëtorit 5% shumë prej 270.95 Euro, në emër të punëdhënësit 5% shumën prej 270.95 Euro, ndërsa duke filluar nga 30.06.2016 t'ia kompensoj paditësit pagën sipas gradës 7 derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, si dhe administratës tatimore e paditura në emër të kësaj difference duhet t'i kompensoj tatimin prej 514.90 euro, në emër të kamatës ligjore shumën prej 159.41 euro, bruto paga në shumë të përgjithshme prej 5,419.25 € dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës palës paditëse në shumë të përgjithshme prej 140 € të gjitha këto kërkesa në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës të shkallës së dytë në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit ose të njëjtat të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Paditësi, me padi dhe precizimin e padisë gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadiës duke theksuar se vendimi i të paditurës nr..., i dt.07.03.2012, është i kundërligjshëm duke kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta anuloj, dhe ta detyroj të paditurën që ti kthej gradën prej 6 në 7, të cilën gradë e ka pas të caktuar sipas kontratës së punës, të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, nr. 01-..., datë 20.10.2011. Ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadiës të precizuar në seancën e datës 20.10.2016, ashtu që të detyrohet e paditura ti kompensoj paditësit diferencën prej gradës 6 në 7, për të ardhurat në shumën neto 4,634.15 €, për trustin pensional 270.95 €, për administratën tatimore 514.90€ (për të ardhurat bruto 4,793.56€), si dhe kamatën ligjore në shumë prej 159.14 €.

E paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar, i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, administrimit të provave dhe vlerësimin të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dipsozitiv të aktgjykimit të përshkruar si më lartë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë nr. 01-..., datë 20.10.2011. Sipas kontratës së punës paditësi pranë të paditurës përcaktohet se do të kryej detyrat e punës ..., Sipas nenit 5 të kontratës është përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 7, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-ës, nr.01-..., të datës 28.02.2005, së paku njëherë në muaj, e cila nuk mund të jetë më e ultë se paga minimale. E paditura me vendimin nr..., i datës 07.03.2012, paditësit i cakton të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 6 sipas strukturës së gradave, duke i ul paditësit gradën nga 7 në gradën 6. Sipas këtij vendimi lartësia e të ardhurave personale implementohet nga data 01.02.2012, e gjithashtu ky vendim sipas të paditurës konsiderohet pjesë përbërëse e kontratës së punës nr. 01-..., datë 20.10.2011.

Gjykata e shkallës së parë më tej thekson se kontrata është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës. Me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës, parashihet përmbajtja e kontratës së punës, përveç të tjerave sipas nenit 11. 1.11 kontrata e punës duhet të përmbajë “lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”, në rastin konkret palët me kontratë përkatësisht me nenin 5 të kontratës kanë përcaktuar se të punësuarit-paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 7, dhe bazuar në këtë dispozitë kushtet e kontratës të lidhur mes paditësit dhe të paditurës, kanë përfshirë edhe lartësinë e pagës përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditësit, andaj këto kushte janë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, për të cilën arsye është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës nr.01-..., i datës 07.03.2012, dhe duke aprovuar kërkesën për pagesën e diferencës së pagës.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se mos realizimi i diferencës së pagave për periudhën kontestuese, për paditësin përfaqëson humbje të fitimit i cili ka karakterin e dëmit material, si rezultat i kësaj gjendje faktike e mbi bazën e dispozitave të lartshënuara kjo gjykatë aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare, po ashtu pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje nga neni 182.2. pika n) të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë e ka arsyetuar aktgjykimin e saj për të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura, përfshirë edhe vlerësimin për shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Në këtë kontekst aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet ankimore sa i përket shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka pranuar si të bazuar padinë e paditësit, andaj edhe kjo gjykatë e pranon të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ultë, sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar se paditësi në bazë të kontratës së punës lidhur me të paditurën ka pasur gradën e të ardhurave personale 7, në bazë të nenit 5 të kësaj kontrate.

Sikurse të dy gjykatat edhe kjo Gjykatë mendon se paditësi ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 7-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe dispozitën e nenit 55 par. 1, të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 – të Republikës së Kosovës), ku është përcaktuar se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së dytë, nuk ka vlerësuar të gjitha thëniet në ankesë, pasi që gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar të gjitha thëniet e ankesës të paditurës duke dhënë arsyet e mjaftueshme dhe bindëse, të cilat janë të pranuar edhe nga kjo gjykatë. Thëniet tjera në revizion janë përsëritje e pretendimeve ankimore të cilat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212–të RK) është caktuar se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës e në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 7-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe ligjin. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me uljen e shpenzimeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative e as që thuhet për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, çka thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara.

Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave dhe se nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues.

Pretendimi se Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes nuk ka thirrur palët dhe përfaqësuesit e tyre në seancën e shqyrtimit, është tërësisht i pa bazuar, pasi në rastin konkret është vendosur konform nenit 195 par.1, pika d) të LPK-së, sipas të cilës dispozitë vendosja mund të bëhet në seancën e kolegjit.

Pretendimi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë, duke e tejkaluar të njëjtën, që paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika o) të LPK-së, është pretendim i pa bazuar, pasi gjykata ka vendosur sipas precizimit dhe brenda kërkesës së paditësit.

Pretendimi në revizion se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për anulim të vendimit të paditurës me të cilin paditësit i është ulur grada nga 7 në 6, kurse ky vendim ka prodhuar efekt, përkatësisht uljen e pagës nga grada 7 në 6, dhe është paraparë të obligohet e paditura që paditësit ti paguaj diferencën nga data 01.02.2012, e deri me 30.06.2016, ndërsa duke filluar nga 30.06.2016, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë faktin që paditësi me të paditurën ka lidhur kontratë të re të punës më datë 02.02.2015, me numrin 01-..., sipas të cilës kontratë, paditësi është pajtuar që nga kjo datë të paguhet me pagën sipas lartësie së gradës 6, pra sipas vendimit të marr nga e paditura për uljen e gradave, ky pretendim për Gjykatën Supreme është i pa bazuar për faktin se pala e paditur gjatë shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave nuk është prezantuar kontrata nr.01-..., datë 02.02.2015, dhe nuk është propozuar të administrohet si provë, kjo vërtetohet edhe nga procesverbali i datës 20.10.2016, në të cilën seancë ka qenë prezent i autorizuari i të paditurës H. I., me autorizim në shkresat e lëndës. Po ashtu edhe në ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë nuk është parashtruar si pretendim ankimor, dhe nuk është prezantuar si provë e bashkangjitur ankesës. Ndërsa nëse marrim parasysh dispozitën e nenit 216 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar “Palët mund të parashtrorjnë me revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë”, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë, andaj edhe nuk mund të merret për bazë kontrata e paraqitur me revizion nr.01-..., datë 02.02.2015 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit.

Gjykata Supreme nuk mund të vlerësoj vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, andaj pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk mund të vlerësohen, pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”, andaj në rastin konkret deri sa pala e paditur nuk ka parashtruar si propozim për administrimin si provë të kontratës së nr.01-..., datë 02.02.2015, të lidhur në mes të paditurës dhe paditësit, në gjykatën e shkallës së parë, nuk kemi edhe aplikim të

gabuar të drejtës materiale, pasi gjykata gjykon brenda kërkesave dhe në bazë të provave të propozuara nga palët, dhe nuk ka detyrim të bëjë hetime për ekzistimin e provave të mundshme, dhe ky detyrimi i gjykatës dhe palëve është përcaktuar me nenin 7, 8, 319 dhe 322 të LPK-së, dhe në rastin konkret barra e të provuarit dhe të propozuarit si të kontratës nr.01-..., datë 02.02.2015, të lidhur në mes të paditurës dhe paditësit, ka qenë e të paditurës.

Pretendimi lidhur me vendosjen për kamatëvonesën e gjykuar, është tërësisht i pa bazuar pasi që kamata është gjykuar konform ekspertizës së kryer financiare, të cilën nuk e ka kundërshtuar gjatë shqyrtimit i autorizuari i të paditurës, po ashtu gjykimi i kamatëvonesës është konform dispozitave ligjore dhe praktikës së krijuar të Gjykatës Supreme.

Për shkak se me pretendimet e revizionit në asnjë mënyrë nuk vihet në pikëpyetje ligjshmëria e aktgjykimit të goditur me revizion, revizioni i të paditurës u refuzua si i pabazuar.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.6/2020, datë 26.10.2021

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi